



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 138 Prot.

Tiranë, më 30.01 2018

**VENDIM Nr. 7, datë 18.01.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, datë 18.01.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Ndërtimi i HEC "MIRESHI", në përroin e Mireshit, degë e lumit Drini i Zi, Bashkia Bulqizë*"-subjekti "GERTI" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Ndërtimi i HEC "MIRESHI", në përroin e Mireshit, degë e lumit Drini i Zi, Bashkia Bulqizë*"-subjekti "GERTI"sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka.
2. Subjekti "GERTI" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "*Ndërtimi i HEC "MIRESHI", në përroin e Mireshit, degë e lumit Drini i Zi, Bashkia Bulqizë*", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E KULTURES**  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**